

VENDIM
Nr.85, datë 14.12.2009

PËR TËRHEQJEN NGA QARKULLIMI TË DISA KARTËMONEDHAVE ME KURS
LIGJOR

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4 shkronja “b”, të nenit 40, pika 5, të nenit 43, shkronjat “c” dhe “d”, të ligjit 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të kreut II të udhëzimit “Për hedhjen në qarkullim të prerjeve të reja të kartëmonedhave dhe monedhave kombëtare e për tërheqjen nga qarkullimi i parasë”, miratuar me vendimin nr.27, datë 30.3.1998 të Këshillit Mbikëqyrës; të kreut II pika 5 të rregullores “Për funksionimin e Departamentit të Emisionit”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 28.3.2001 të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar; dhe me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave me kurs ligjor si më poshtë:
 - a) Kartëmonedha prerje 500 lekë, emetim i vitit 1991,1992,1993,1996,1997, imazhi lule dielli; dhe
 - b) Kartëmonedha prerje 500 lekë, emetim i vitit 1992, 1994, 1996, imazhi i Naim Frashërit.
 - 2) Kartëmonedhat me prerjet dhe emetimet e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi do të kenë kurs ligjor deri në datën 30.6.2010.
 3. Kartëmonedhat me kurs ligjor sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi do të mbliidhen për këmbim kundrejt pagesës së vlerës fillestare të emetimit me kartëmonedha dhe monedha të tjera në qarkullim deri në datën 31.12.2012.
 4. Ngarkohen të gjitha bankat, degët e bankave të huaja dhe zyrat e këmbimit valutor të pranojnë për këmbim deri në datën 31.12.2012, kartëmonedhat me kurs ligjor sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi dhe t’i dërgojnë ato menjëherë pranë Bankës së Shqipërisë dhe degëve të saj.
 5. Ngarkohet Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës me zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani